

ACIBADEM | SISTINA

# CHECKUP

DEPARTAMENTI I PARË I SPECIALIZUAR  
PËR EKZAMINIME PARANDALUESE



Spitali klinik “Acibadem Sistina” ofron programe standarde parandaluese për kontrollin e shëndetit dhe të përshtatur nevojave tuaja individuale, sipas moshës, gjinisë, shpeshtësisë së sëmundjeve të caktuara në familje, si dhe në përputhje me mënyrën tuaj të jetesës. Në këtë mënyrë mundësohet zbulimi i hershëm dhe parandalimi i sëmundjeve duke filluar në kohë me trajtimin e duhur. Paketat shëndetësore parandaluese individuale janë projektuar në mënyrë racionale, efektive dhe të përballueshme për buxhetin tuaj.

### **ÇFARË ËSHTË EKZAMINIMI PARANDALUES?**

Ekzaminimi parandalues është një program i projektuar për pacientët të cilët nuk kanë probleme shëndetësore, me anë të të cilit atyre u jepet mundësi për të kryer ekzaminime dhe analiza të cilat kanë për qëllim zbulimin e hershëm të disa sëmundjeve të caktuara, duke përfshirë edhe konsulta dhe këshilla për një jetë të shëndetshme dhe kontroll të plotë të organizmit tuaj.

### **PËRSE ËSHTË I NEVOJSHËM KY EKZAMINIM PARANDALUES?**

Ju ndoshta mendoni se nuk është e nevojshme që të shkoni në spital dhe të vizitoni mjekun, ndoshta nuk mendoni se është e nevojshme që të kryhen ekzaminime shëndetësore përderisa ndiheni mirë. Megjithatë, ekziston një numër i madh rreziqesh shëndetësore me të cilat përballemi. Faktorët që lidhen me mënyrën tuaj të jetesës, predispozita gjenetike ndaj sëmundjeve (psh: manifestimi i diabetit, sëmundjet e zemrës apo kanceri tek anëtarët e familjes) mund t'i përcaktojnë rreziqet tuaja shëndetësore. Në këtë aspekt, ekzaminimet parandaluese luajnë një rol të rëndësishëm në zbulimin e hershëm të sëmundjeve. Duke përkushtuar disa orë në realizimin e ekzaminimeve parandaluese, mund t'i të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me shëndetin tuaj dhe t'i parandalojnë problemet serioze në lidhje me shëndetin tuaj në të ardhmen.

## PAKETA CHECK-UP PËR FËMIJË DERI NË 16 VJEÇ

- EKZAMINIM SPECIALISTIK PEDIATRIK
- EKZAMINIM ORTOPEDIK TRAUMATOLOGJIK
- EKZAMINIM SPECIALISTIK ORL
- EKZAMINIM STOMATOLOGJIK
- EKZAMINIME EKO
- STRISHO E HUNDËS
- STRISHO E FYTIT - BAKTERIOLOGJIKE
- PASQYRA E GJAKUT
- PROTEINA C REAKTIVE (CRP) KUANTITATIVE
- ALANINË AMINOTRANSFERAZA (ALT)
- ASPARTATE AMINOTRANSFERAZA (AST)
- TIBC - KAPACITETI TOTAL I LIDHJES SË HEKURIT
- HEKUR NË SERUM
- GLUKOZË, NË STOMAK BOSH
- KREATININË
- BBILIRUBINA TOTALE
- ANALIZA BIOKIMIKE E URINËS ME SEDIMENT

**18.600 DENARË**

ACIBADEM | SISTINA

CHECKUP

## Informacione për kontakt

**Adresa:** Skupi 5a Shkup, R. e Maqedonisë

**E-posta:** [checkup@acibademsistina.mk](mailto:checkup@acibademsistina.mk)

call center  
((+389 2 3099 500))  
[www.acibademsistina.mk](http://www.acibademsistina.mk)